



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
REKTORI

Nr. 27/3 prot

Tiranë, më 13 11 .2025

UDHËZIM
Nr. 8, datë 13 11 .2025

**“PËR PUNËSIMIN E PERSONELIT AKADEMIK TË FTUAR
NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenet 3, 39 dhe 62; VKM nr. 748, datë 11.6.2009 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë”, i ndryshuar; në Statutin e UMT-së, nenet 5, 29 dhe 65; Udhëzimi i MAS nr. 29, datë 10.9.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, në Rregulloren e UMT-së, neni 56; në nevojat për punësimin e personelit akademik të ftuar nga jashtë UMT-së në njësitë bazë dhe njësitë kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, si dhe me qëllim zhvillimin normal të procedurave përkatëse,

UDHËZOJ:

- I. Punësimi i personelit akademik të ftuar nga njësia bazë, njësia kryesore në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë
1. Ky udhëzim përcakton procedurat, kriteret dhe përgjegjësitë për përzgjedhjen, ftesën, kontraktimin si dhe shpërblimin e personelit akademik të ftuar nga njësitë bazë dhe njësitë kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
 2. Personel akademik i ftuar konsiderohet çdo individ/personalitet/studiuues vendas ose i huaj, me kualifikime të larta akademike, shkencore, artistike ose profesionale, që angazhohet përkohësisht në veprimtari mësimdhënieje¹ në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, i cili nuk ka qenë më parë dhe nuk është aktualisht pjesë e strukturave organizative të përhershme të tij.

¹ 4. Mësimdhënia përfshin: a) Veprimtarinë në auditor si vijon: i. Leksione. ii. Seminare. iii. Lëndë speciale. iv. Ushtrime. v. Laboratorë. vi. Projekte kursi. vii. Detyrë kursi. viii. Atelier. ix. Praktika klinike. x. Praktika profesionale artistike. b) Veprimtari jashtë auditorit, në mbështetje të procesit mësimor si vijon: i. Ndjekje dhe/ose drejtim i praktikës mësimore ose profesionale. ii. Konsultime/këshillim studentësh. iii. Udhëheqje diplome të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë. iv. Kontroll i dijeve (provime, kolokutume). v. Përgatitje individuale. vi. Ekspozitë, garë dhe shfaqje. vii. Recensë punimi diplome ciklit të tretë i studimeve. viii. Ndjekja dhe/ose drejtimi i praktikës mësimore/profesionale mjekësore për të gjitha ciklet e studimeve, për kategorinë personel akademik me kohë të plotë”.

3. Kandidatët të cilët propozohen me vendim të njësisë bazë ose të dekanatit të njësisë kryesore, duhet të jenë studiues, personalitete, persona publikë, vendas apo të huaj, të shquar, të mirënjohur për kontributin e tyre në fusha të ndryshme, në veçanti në fushën e shkencave të shëndetit.
4. Propozimi duhet të ketë të argumentuar arsyet për të cilat ftohet ky personalitet i shquar dhe i mirënjohur në fushën e tij, si dhe kontributin që synohet të japë në fushën përkatëse.
5. Punësimi i personelit të ftuar ka karakter të përkohshëm, nuk krijon marrëdhënie të qëndrueshme pune me institucionin dhe rregullohet përmes kontratës individuale për një periudhë të përcaktuar.
6. Personeli akademik i ftuar gëzon të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në kontratë, në përputhje me Statutin dhe rregulloret e brendshme të institucionit.
7. Në të gjitha rastet personeli i ftuar në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë nuk mund të kryejë më shumë se 25 (njëzet e pesë) orë, ngarkesë mësimore në auditor. Për raste të veçanta, mund të propozohet edhe për një sasi më të madhe të orëve të veprimtarisë, propozim i cili duhet të jetë i argumentuar dhe miratuar nga Rektori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
8. Njësitë bazë dhe/ose drejtuesi i grupit mësimor-kërkimor (seksionit) kanë të drejtë të paraqesin propozimet e tyre në Dekanatin e njësisë kryesore, si rregull jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga fillimi i semestrit. Lista e personaliteteve që propozohet të ftohen, shoqërohet me jetëshkrimin e plotë të tyre, llojin e aktivitetit që do të kryejë (leksione, seminare, kërkim shkencor, etj.) apo fushën e kërkimit ku do të kontribuojnë, si dhe periudhën kohore kur do të aktivizohen.
9. Pas miratimit paraprak nga drejtuesi i njësisë kryesore, lista përcillet për miratim përfundimtar nga Rektori.
10. Procedura e kontraktimit të personelit akademik të ftuar:
 - a. Pas miratimit të kandidatit, përgatitet kontrata individuale, ku përcaktohen:
 - i. viti akademik dhe semestri në të cilin do të ftohet ky personel;
 - ii. kohëzgjatja e angazhimit (përcaktim i orëve të mësimdhënies);
 - iii. fusha në të cilën do të zhvillohet veprimtaria mësimore/kërkimore-shkencore;
 - iv. shpërblimi dhe burimi i fondeve (nëse ka të tilla);
 - v. të drejtat dhe detyrimet e palëve.
 - b. Kontratat nënshkruhet nga Rektori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe personeli i ftuar.
 - c. Struktura e Burimeve Njerëzore në njësinë kryesore dhe UMT mban dosjen përkatëse për çdo personel të ftuar, e cila përfshin CV-në, kontratën dhe dokumente të tjera përgjatë procesit të propozimit dhe miratimit të personelit të ftuar.
11. Mbikëqyrja dhe raportimi për veprimtarinë e kryer nga personeli akademik i ftuar.
 - a. Njësitë bazë raportojnë periodikisht tek drejtoria/struktura që mbulon fushën akademike për numrin, fushat dhe ndikimin e angazhimeve të personelit të ftuar.

- b. Ky raport i kalon edhe strukturës ekonomiko-financiare me qëllim realizimin e pagesës (nëse do të ketë) për personelin e ftuar.
 - c. Përcaktimi i masës së honorareve bëhet me vendim të Rektoratit, pasi të jetë miratuar më parë nga Bordi i Administrimit të UMT-së. Të gjitha shpenzimet për personelin akademik të ftuar përballohen nga të ardhurat e njësive kryesore dhe UMT-së.
12. Njësitë kryesore, duhet të parashikojnë në fillim të çdo viti kalendarik, një zë të veçantë shpenzimesh për përballimin e pagesës nga të ardhurat e veta, për personelin akademik, studiuesin apo personalitetin e ftuar.
- II.** Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi njësitë kryesore të UMT-së, si edhe Drejtoria e Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore në Rektoratin e UMT-së.

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI
Prof. Dr. XHELA DIN DRAÇINI

The image shows an official circular stamp of the University of Medicine and Dentistry of Tirana (UMT). The stamp contains the text "REPUBLIKA E SHQIPËRIE", "UNIVERSITETI I TIRANË", and "Fakulteti i Mjekësisë". In the center of the stamp is the coat of arms of Albania. Overlaid on the stamp is a large, bold, handwritten signature in black ink.